



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

NDËRMARJA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË ARSIMIT DHE ÇERDHES KORÇË

RELACION

Për

Miratimin e disa shtesave për bursa për nxënësit e arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2023-2024 në Institucionet Arsimore Publike

Mbështetur në shkresën Nr.6470/95Prot, Datë.20.11.2023 “Për planifikimin e numrit të bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar , për vitin shkollor 2023-2024” , drejtuar Bashkisë Korçë, si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.666 datë.10.10.2019 për “Kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe percaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, dhe sipas vendimit nr.511 datë 27.07.2022 për “Disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.666 datë.10.10.2019”, të ndryshuar, për vitin shkollor 2023-2024, si dhe në zbatim të Ligjit 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”,

Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit e Çerdhes, kërkon shtesë për disa bursa të nxënësve të arsimit parashkollor , sepse për disa arsye objektive të prindërve dhe kujdestarëve ligjore të fëmijëve të braktisur, **dokumentacioni i nevojshëm sipas kriterëve të mëposhtme:**

- Sipas pikës 2.1 (Kriteri ekonomik) gërma a), b), c).
- Sipas pikës 2.3 (Kriteri joekonomik) gërma a), b), c), ç), d), dh), e), ë), g).
- Sipas pikës 2.4 (Kriteri i degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm) gërma a).

është paraqitur me vonesë tek institucionet arsimore parauniversitare.

Dhe duke u mbështetur tek Pikat :

- Sipas pikës 5 . ku shprehimisht thuhet : **Njësitë e vetqeverisjes vendore, për kategorinë e nxënësve që janë regjistruar në arsimin bazë, por që në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë dhe për uljen e braktisjes shkollore të arsimit bazë, mund të miratojnë dhe të shpërndajë bursa edhe nga fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar.**

Bashkëngjitur këtij relacioni janë vendosur edhe listat emërore të nxënësve që plotësojnë kriteret për të përfituar bursë sipas shkollave , klasave dhe listat të nxënësve përfitues të kuotës financiare të veshmbathjeve.

Konceptoi : Sonjela Zguri


Drejtori i NSHMAÇ-së

Ylli MUSAKA



Drejtoresha e Dr. së përgjithshme Juridike
dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Anxhela DISHNICA (QERAMIXHI)



KRYETARI

Sotiraq FILO